



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 209, Datë 11.12.2020**

**MBI**

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” SH.P.K., NR. 322, SERIA F15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S, NR. 159, DATË 28.12.2015.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma ç) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma d); nenit 5, pika 1, gërma d); nenit 13 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 11.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/2 Prot, datë 09.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 172, datë 04.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA sh.p.k, nr. 322, Seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 159, datë 28.12.2015.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/33 prot., datë 06.11.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1183 prot., datë 09.11.2020, ERE i'u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k. me shkresën nr. 11120/EXTRA prot., datë 12.11.2020, dërguar në ERE me e-mailin e po të njëjtës datë, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 322, Seria F15 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 159, datë 28.12.2015, me afat 5 vjeçar.
- Vlefshmëria e licencës së shoqërisë “ENERGIA GAS AND POWER” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike përfundon në datën 28.12.2020 dhe shoqëria e ka depozituar aplikimin e saj në ERE, brenda afatit që përcakton neni 16, pika 1, sipërcituar, (datë 22.10.2020).
- Dokumentacioni i aplikimit është tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë rinovimin e licencës nr. 306, Seria FK15, të shoqërisë “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit nr. 159, data 28.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 29.12.2020.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**